



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

Pranuar më: 24.12.2025		
Prilajeno:		
Njësia Jednig:	Nr. Broj:	Shtojca Dodatak:
05-453/01-69421		



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Nenit 8 të Rregullores mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve nr. MF04/2017 si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr. 110-78095 i datës 24.12.2021, shpallë:

THIRRJE PUBLIKE PËR OJQ 17 Shkurt Dita e Pavarësisë 2026

Bazuar në rregulloren e MF-NR-04/2017 mbi kriteret,standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve:

1.Drejtoriati për Kulturë,Rini dhe Sport bën thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës që selin dhe adresën e OJQ-së apo Shoqatës e kanë në teritorin e Komunës së Lipjanit, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Kulturës, Sportit të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në Kulturë dhe Sport në Komunën e Lipjanit.

2.Organizatave jo-qeveritare mund të aplikojnë me një projekt përme aktiviteteve si më poshtë:

2.1.Aktivitetet që kanë për qëllim nxitjen e autoriteteve locale,institucionet publike dhe akterëve tjerë për bashkëpunim me shoqërinë civile në promovimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive.

2.2.Aktivitete që synojnë avancimin e politikave locale dhe qeveritare në fushën e avancimit dhe promovimit të kulturës.

3.Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 7,000.00 euro.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për këtë projekt është 501.00 euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 7,000.00 euro.

4.Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me 19.01.2026.

5.OJQ-të mund të aplikojnë më së shumti me një (1) projekte në kuadër të kësaj thirrje,ndërsa periudha e zbatimit të projektit është 1 muaj.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-qeveritare me Seli dhe Adresë në Komunën e Lipjanit para dates së publikimit të thirrjes publike.

OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e promovimit të kulturës dhe sportit.

OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve të tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale.

6. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare (web faqen www.komunaelipjanit-rks.org).

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme:

KOMUNA E LIPJANIT

Rruga „Shqipëria”

Zyra për Shërbim të Qytetarëve nr.1 dhe nr.2.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar Brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

7. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën (mergim.oruci@rks-gov.net)

Datë: 24.12.2025
Lipjan

z. Imri Ahmeti

Kryetari i Komunës

